



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
URDHRI I PSIKOLOGUT**



**Tiranë, më 02.07.2025**

**Lënda:** Deklaratë për median

**Drejtar:** Mediave audiovizive dhe të shkruar

**Dr. Valbona Treska zgjidhet anëtare e Bordit të Drejtoreve të Federatës Evropiane të Shoqatave të Psikologëve (EFPA)**

Më 1 Korrik 2025, në Paphos, Qipro, gjatë Asamblesë së Përgjithshme të Federatës Evropiane të Shoqatave të Psikologëve (EFPA), Dr. Valbona Treska, Presidente e Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë, u zgjodh anëtare e Bordit të Drejtoreve të EFPA-s.

Në këtë Asamble morën pjesë 110 delegatë nga 37 vende anëtare të EFPA-s, organizata më e lartë përfaqësuese e profesionit të psikologjisë në Evropë. EFPA përfaqëson mbi 300,000 psikologë nga i gjithë kontinenti dhe luan një rol kyç në zhvillimin e politikave profesionale, etike dhe akademike në fushën e psikologjisë. Zgjedhja e Dr.Treska në këtë pozicion përfaqëson një moment historik për Shqipërinë, pasi është hera e parë që një përfaqësues shqiptar zgjidhet në një nivel kaq të lartë drejtues në strukturat evropiane të psikologjisë.

Për Dr. Treska, kjo zgjedhje është finalizimi i një rruge të gjatë dhe të konsoliduar në arenën ndërkombëtare të psikologjisë. Në vitin 2021, ajo u vlerësua nga Shoqata Amerikane e Psikologjise (American Psychological Association – APA) me Çmimin e Lartë Presidencial, **"Për lidership të jashtëzakonshëm në zhvillimin e Urdhrit të Psikologut në Shqipëri"**.

Dr.Treska do të ushtrojë këtë mandat pranë Presidentes së sapozgjedhur të EFPA-s, Znj.Sofia Ramalho (Portugali), si dhe anëtarëve të tjerë të Bordit: John Francis Leader (Irlandë), Ole Tunold (Norvegji), Caterina Arcidiacono (Itali), Robertas Povilaitis (Lituani) dhe Lotte De Schrijver (Belgjikë).

Ky përfaqësim i Shqipërisë në këtë strukturë është një hap domethënës për afirmimin e rolit të profesionistëve shqiptarë në politikëbërjen evropiane për psikologjinë, si dhe një mundësi konkrete për të sjellë perspektivën dhe zërin e vendeve të vogla në qendër të zhvillimeve.

**Ky përfaqësim është gjithashtu një dëshmi e maturimit profesional të psikologjisë shqiptare dhe një mundësi reale për të ndikuar në zhvillimet evropiane në fushën e shëndetit mendor, arsimit dhe etikës së profesionit.**

**Në të njëjtën Asamble, Shqipërisë iu besua me 100 vota të plota e drejta historike për të organizuar Kongresin Evropian të Psikologjisë (ECP 2029) në Tiranë.**



Ky vendim unanimi është një moment kthese për vendin tonë dhe një akt i fuqishëm besimi nga komuniteti profesional evropian. Në katër vitet në vijim, Shqipëri do të punojë me përkushtim për të mirëpritur në kryeqytet rreth **2500–3000 pjesëmarrës** nga e gjithë Evropa dhe më gjerë.

**Psikologët evropianë do të zbarkojnë në Shqipëri** dhe Tirana do të shndërrohet në qendrën e dijes, shkëmbimit shkencor dhe zhvillimit bashkëkohor profesional. Ky kongres është jo vetëm një ngjarje akademike, por edhe një vitrinë e denjë për vendin tonë, për të treguar nivelin e organizimit, mikpritjes dhe vizionit evropian të psikologjisë shqiptare.

Një ngjarje e këtyre përmasave do të ketë gjithashtu ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në ekonominë lokale, përmes turizmit profesional, konsumit të shërbimeve dhe rrithjes së profitit ndërkombëtar të Shqipërisë si destinacion mikpritës për ngjarje shkencore dhe kulturore të nivelit të lartë.

Ky sukses nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e institucioneve shtetërore dhe partnereve strategjikë vendas e ndërkombëtarë që besuan në potencialin e Shqipërisë si mikpritëse e një ngjarjeje të këtij niveli.

### **Urdhri i Psikologut**

